



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Selediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 132/26 Dt. 25.03.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 paragrafi g, të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e koordinorit për Menaxhimin e Qendrës për Angazhim të Komunitetit

1. Venera Rada caktohet koordinatorë për menaxhimin e Qendrës për Angazhim të Komunitetit (QAK) në Komunën e Prizrenit.
2. Me këtë vendim, znj. Venera Rada autorizohet të shfrytëzojë hapësirat e Qendrës për Angazhimin e Komuniteteve (QAK) në Prizren për zbatimin e aktiviteteve në kuadër të projektit “E Ardhmja e Saj”, të financuar nga BMZ dhe të zbatuar nga PREDA Plus dhe WEntrepreneur, me mbështetje të ASB.-së
3. Aktivitetet përfshijnë:
 - 3.1. Koordinimin e Grupit Rajonal të Punës për hartimin e masës strategjike “Ndërmarrësia e Grave”;
 - 3.2. Mbështetjen e skemës së granteve për bizneset e reja të grave;
 - 3.3. Inkurajimin dhe përkrahjen e vajzave dhe grave për pjesëmarrje në Kampin Intensiv për Ndërmarrësi;
 - 3.4. Mbështetjen e organizimit të panairit të grave sipërmarrëse;
 - 3.5. Formalizimin e iniciativës së grave në degë rajonale për mbështetjen e ndërmarrësisë së grave, në përputhje me prioritetet zhvillimore të Komunës së Prizrenit.
 - 3.6. Përveç aktiviteteve të lartpërmendura, znj. Venera Rada autorizohet të shfrytëzojë hapësirat e QAK-së edhe për zhvillimin e aktiviteteve të tjera që synojnë fuqizimin ekonomik dhe social të grave dhe vajzave, promovimin e ndërmarrësisë së grave, si dhe rritjen e pjesëmarrjes së tyre në jetën ekonomike dhe shoqërore në nivel lokal.
4. Obligohet e lartcekura për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Të lartcekurës,
 - Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
 - Organeve tjera kompetente,
 - Arkivës së Kryetarit.

